

AKTTHEMELIMI DHE STATUT: "BRIDO" SHPK

AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI I
SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"BRIDO" SHPK

AKT THEMELIMI DHE STATUT: "BRIDO" SHPK

AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "BRIDO" SHPK

STATUT

**PER KRIJIMIN E PERSONIT JURIDIK, SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE
KUFIZUAR: "BRIDO" SHPK**

Sot më datë 30.03.2022, unë shtetasi si më poshtë, vijon:

**z. Muhamrem Domi, Shtetas Shqiptare, lindur më 24.07.1979 në Qytetin e Shijakut
dhe banues në Tiranë, mbajtës I letërnjoftimit me numër Personal: H90724133B,
madhor e me zotësi të plotë juridike për të vepruar;**

Në mbështetje të dispozitave ligjore të Kodit Civil në Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008,
vendosëm themelimin e Shoqërisë Tregtare "BRIDO" SH.P.K., shoqëri private e së
drejtës Shqiptare, krijimi, funksionimi I së cilës përcaktohet si më poshtë vijon:

KREU

EMRI I SHOQERISE, SELIA, KOHEZGJATJA, OBJEKTI

NENI 1 EMERTIMI I SHOQERISE

- 1.1 Emri i shoqërise me pergjegjësi së kufizuar është "**BRIDO**" SHPK (më poshtë e quajtur "Shoqëria"), person juridik privat I së drejtës Shqiptare, I themeluar dhe do të ushtrojë veprimtarinë në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë. Kjo shoqëri në llojin e saj është Shoqëri me Përgjegjësi të kufizuara.
- 1.2 Veprimtaria dhe funksionimi I kësaj Shoqërie rregullohet sipas neneve të statutit të kësaj shoqërie dhe në përputhje me ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqritë Tregtare".

NENI 2 SELIA

- 2.1 Selia e Shoqerise ndodhet ne adresën: Rruga "Muhamet Gjollesha", Tiranë, (pasuria nr. 6/164-N16, ZK 8210), Lloji Pasurisë Njësi, Kati 0.
- 2.2 Asambleja e Pergjithshme mund të vendosë mbi transferimin e selisë së Shoqërisë në një adresë tjeter. Organi administrues i Shoqerise mund te themeloje ose mbyllë dege dhe/ose zyra perfaqesimi, brenda apo jashte Republikës se Shqiperise.

NENI 3 VULA E SHOQERISE

- 3.1 Shoqëria ka vulën e saj, do të jetë si vijon: "BRIDO" sh.p.k.
- 3.2 Të gjitha Aktet dhe dokumentat që do të nxjerrë Shoqëria drejtuar palëve të treta dhe publikut duhet të tregojnë qartë dhe të lexueshëm emërtimin (llojin) e Shoqërisë



AKT THEMELIMI DHE STATUT: "BRIDO " SHPK

dhe pas emrit do të jenë fjalët “Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar” ose shkurtimi sh.p.k. “BRIDO” sh.p.k.

3.3 Shoqëria ka adresën e saj elektronike: remdomi@hotmail.com

3.4 Shoqëria ka nr. Kontakt të saj: +355682048810

NENI 4 OBJEKTI I SHOQERISE

4.1 Shoqëria ka për objekt te saj kryerjen e të gjitha aktivitetave që një shoqëri me përgjegjësi te kufizuar mund te ushtrojë në bazë të legjislacionit shqiptar, brënda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, duke u fokusuar kryesisht në:

- a) Shërbime ne fushën e bareve, restoranteve, picereve dhe produkteve me karakter ushqimor, si dhe kryerjen e shërbimeve catering (shpërndarje) lidhur me prodhimet e mësipërme.
- b) Hapja e dyqaneve për shitjen me pakicë e produkteve ushqimore te veta ose të të tretëve, tregtimi i ushqimeve dhe pijeve alkoolike dhe jo-alkoolike, për lloje te ndryshme te rosticerise, gastronomise dhe te ngjashme me to.
- c) Krijimi I një Zinxhir Dyqanesh në shitjen me pakicë të Produkteve ushqimorë dhe joushqimorë.

4.2 Për përbushjen e objektit të saj Shoqëria:

- a) Mund të marrë pjesë dhe te jete e interesuar ne shoqeri dhe sipermarrje, shqiptare apo te huaja, qe kryejne aktivitete te njëjtë, te ngjashme apo te lidhura me aktiviteti n e saj ose te subjekteve pjesemarrrese;
- b) Mund të lidhë kontrata shitblerje, përdorimi, shkëmbimi, sipërmarrje apo marrëveshje të tjera me investitorë, bashkë investitorë, pronarë trualli apo objektesh, operatorë dhe administrues te strukturave turistike;
- c) Mund te kryejë te gjithë veprimet e nevojshme ose te dobishme ose qe kane te bejne, perfshire par pa u kufizuar ne: ofrimin e garancive reale dhe/ose personale per detyrimet e veta dhe se te treteve, veprime me pasuri te luajtshme, te paluajtshme, tregtare dhe do veprim tjeter qe ka te beje me objektin e saj ose qe mundeson një perdorim me te mire te strukturave dhe/ose burimeve nepermjet shoqerive ose sipermarrjeve ne te cilat, direkt apo indirekt, Shoqeria ka pjesemarrje apo kontrollin e tyre.

4.3 Shoqëria mund te veprojë ne Shqipëri dhe jashtë saj dhe te kryejë do aktivitet tjetër te lidhur, ndihmës me qëllim te përbushe ose te jetë i dobishëm për perm bushjen e objektit te saj.

NENI 5 KOHEZGJATJA E SHOQERISE

5.1 Shoqëria do të zhvillojë Veprimtarinë e saj për një kohë pa afat.

5.2 Ajo mund të shpërndahet para afatit me vendim të Ortakut, ose per shperndarje e saj e percakton vetë legjislacioni ne fuqi.

**AKT THEMELIMI DHE STATUT: "BRIDO " SHPK
KREU II**

KAPITALI, KALIMI I KUOTAVE, ZMADHIMI DHE ZVOGELIMI I KAPITALIT

**NENI 6
KAPITALI I SHOQERISE**


- 6.1 Kapitali i Shoqërisë ndahet në një numët kuotash, në raport me kontributin dhënë nga cdo ortak në Shoqëri. Cdo Ortak zotëron një kuotë të vetme në Shoqëri. Bashkëzotëruesit e një kuote, sipas nenit 72, të këtij ligji, gëzojnë cilësinë si një ortak I vetëm.
- 6.2 Kapitali fillestar për ushtrimin e veprimtarisë së Shoqërisë është 10.000 (Dhjetë mijë) Leke.
- Pjesëmarrja e themeluesit ne Kapitalin e Shoqërise ështe në përputhje me kontributet e tij si më poshtë:
1. Ortaku Vetëm Themelues **z. Muharrem Domi, mbajtës I letërnjoftimit me numër Personal: H90724133B**: Zotëruesh I një kuote të vtmë me vlerë nominale 10. 000 (dhejtë mijë) lekë dhe përfaqëson 100% të Kapitalit Themeltar.

Kapitali i Shoqërisë nënshkruhet menjëhere dhe do të paguhet nga ortaku që zoteron, 100 % (njeqind per qind) të kontributeve në kapitalin e shoqerisë.

- 6.3 Në rast zmadhimi apo zvogëlimi të kapitalit themeltar te Shoqërisë, ortakët do të kenë të drejtën e nënshkrimit të zmadhimit apo zvogëlimit të kapitalit në përpjesëtim të drejte me pjesëmarrjen që zotëron secili në kapitalin e Shoqërisë.

**NENI 7
KALIMI I KUOTAVE ME TRASHEGIMI OSE SI PASOJE E FALIMENTIMIT**

- 7.1 Ne rast se nje ortak apo nje bashkezoterues i nje kuote humb jeten, trashegimtaret e tij do te jene te vetmet persona qe do ti njihet titulli mbi kuoten nga Shoqeria por asnjë nga keto parashikime nuk Jironpergjegjesite e trashegimtareve nga do detyrim i mbartur nga kuota e zoteru a r. Ne rastin e vazhdimit te Shoqerise me disa trashegimtare te ortakut qe ka humbur jeten, trashegimtaret duhet te caktojne nje perfaquesues te perbashket.
- 7.2 Personi qe fiton te drejten mbi nje kuote si pasoje e humbjes se jetes ose falimentimit te nje ortaku mund te zgjedhe te behet zoterues i kuotes ose te kerkoste regjistrimin e kuotes ne emer te nje personi tjeter te caktuar prej tij si perfittues i kuotes . Nese personi i mesiperm zgjedh te behet zoterues i kuotes, ai njofton Shoqerine ne lidhje me kete zgjedhje. Nese personi i mesiperm zgjedh te kerkoste regjistrimin e kuotes ne emer te nje personi tjeter atehere ai duhet ta kryeje ate nepermjet nje akti te vlefs hem te transferimit te kuotes.
- 7.3 Personi qe fiton te drejtat mbi nje kuote si pasoje e humbjes se jetes ose falimentimit te nje ortaku do te kete te drejtat qe gezonte zoteruesi i kuotes, duke perjashtuar te drejten e pjesemarrjes ose te votes ne do mbledhje te Asamblese se Pergjithshme, deri ne momentin e regjistrimit ne regjistrin tregtar si zoterues i kuotes.



AKT THEMELIMI DHE STATUT: "BRIDO " SHPK

NENI 8 ZMADHIMI I KAPITALIT

- 8.1 Asambleja e Pergjithshme mund te zmadhoje kapitalin e Shoqerise, me kuorumin e percaktuar ne nenin 9.12 te ketij Akt Themelimi dhe Statuti. Vendimi i Asamblese se Pergjithshme per zmadhimin e kapitalit do t'i komunikohet me shkrim ortakeve qe jane thirrur por nuk ishin te pranishem ne mbledhjen e Asamblese se Pergjithshme qe vendosi per zmadhimin e kapitalit.
- 8.2 Ne rast zmadhimi te kapitalit, te gjithe ortaket do te kene te drejten te nenshkruajne zmadhimin e kapitalit, ne para ose me kontribuite ne natyre, ne perpjasetim te drejte me kuotat qe zotero jne ne Shoqeri.
- 8.3 Ne rast se disa ortake heqin dore nga e drejta e nenshkrimit te pjeses se tyre, kapitali i panenshkruar mund te nenshkruhet nga ortaket e tjere . Ne kete rast, keta ortake mund te ushtrojne serish te drejten per nenshkrimin e kapitalit, ne perpjasetim te drejte me kuotat e pjesemarrjes ne Shoqeri.

NENI 9 ZVOGELIMI KAPITALIT

- 9.1 Asambleja e Pergjithshme mund te zvogeloje kapitalin e Shoqerise, me kuorumin e percaktuar ne nenin 9.12 te ketij Akti Themelimi dhe Statuti. Ne do rast, kapitali i Shoqerise nuk mund te zvogelohet nen kufirin e percaktuar me ligj.
- 9.2 Ortaket e perballojne zvogelimin e kapitalit te Shoqerise, ne perpjasetim te drejte me pjesemarrjen e tyre ne kapitalin e Shoqerise.

KREU III

ASAMBLEJA E PERGJITHSHME NENI 10 ASAMBLEJA E PERGJITHSHME

- 10.1 Asambleja e Pergjithshme është organi vendimmarrës i Shoqërisë. Asambleja e Pergjithshme vndos mbi te gjitha ceshtjet per te cilat eshte kompetente sipas ligjeve ne fuqi ne Republiken e Shqiperise, sipas ketij Akt Themelimi dhe Statuti dhe/ose do marrëveshje midis ortakëve të Shoqërisë.
- 10.2 Cdo ortak ka te drejte te marre pjese ne mbledhjet e Asamblese se Pergjithshme, te shprehe vullnetin e tij si dhe te votoje ne perputhje me pjeset e kapitalit qe ai zoteron ne Shoqëri.
- 10.3 Cdo ortak mund te perfaqësohet nga një ortak tjetër ose nga një perfaqësues i deleguar me shkrim.
- 10.4 Ortaku nuk mund të delegojë te drejtën e votes per një pjesë te kuotave te tij te kapitalit, nese ai voton personalisht per pjesën e mbetur.
- 10.5 Mbledhja e Asamblesë se Përgjithshme mund te mbahet brënda ose jashtë territorit te Republikës së Shqipërisë. Ortakët ose përfaqësuesit e autorizuar mund te marrin pjese ne mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme nepermjet mjeteve elektronike, perfshire telekonferencen (*conference call*) audio ose video, ne perputhje me legjislacionin per shoqerite tregtare dhe komunikimet elektronike. Mbledhja e Asamblese se Pergjithshme dote quhet e mbajtur ne vendin ku ndodhet Kryetari i saj dhe Sekretari i mbledhjes, me



AKT THEMELIMI DHE STATUT: "BRIDO " SHPK

qellim qe te hartohet dhe te nenshkruhet procesverbali perkates.

10.6 Asambleja e Përgjithshme mund te thirret nga Administratori/et ose nga ortakët që përfaqesojne te pakten 5% te kapitalit te Shoqerise. Thirja e mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme duhet te behët nëpermjet njoftimit me shkrim ose me mjete elektronike, derguar secilit prej ortakeve ne adresat e njoftuara Shoqerise, te pakten 15 (pesembedhjete) dite perpara dates se caktuar per mbledhjen e saj. Njofteji duhet te permbaje rendin e dites, vendin, daten dhe oren e mbledhjes.

10.7 Asambleja e Përgjithshme do të mblidhet rregullisht, pavaresisht nga keto formalitet, ne rast se te gjithe ortaket apo perfaquesuesit e tyre jane te pranishem dhe bien dakord per rendin e dites.

10.8 Mbledhjet e Asamblese se Pergjithshme kryesohen nga Administratori/et. Asambleja e Pergjithshme cakton nje sekretar per do mbledhje midis personave te pranishem.

10.9 Vendimet e Asamblese se Pergjithshme duhet te jene me shkrim dhe te firmosen nga kryetari dhe sekretari. Me kerkese te ortakeve, vendimet duhet te perfshijne dhe deklaratat apo verejtjet e tyre.

10.10 Asambleja e Pergjithshme mblidhet te pakten nje here ne vit, brenda 6 (gjashte) muajve nga mbyllja e vitit finanziar.

10.11 Asambleja e Pergjithshme, ne rastin e vendimeve qe kerkojne shumicen e zakonshme, merr vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese ortaket me te drejte vote ose perfaquesuesit e tyre, qe zoterojne me shume se 30% (tridhjete per qind) te kapitalit te Shoqerise, perve rasteve te parashikuara me poshte ne nenin 9.12. Ne rast se ky kuorum nuk arrihet, Asambleja e Pergjithshme thirret ne nje mbledhje te dyte brenda 30 (tridhjete) diteve nga mbledhja e pare.

10.12 Asambleja e Pergjithshme vendos me votat pro te $\frac{3}{4}$ te ortakeve pjesemarres apo te perfaquesuar qe zoterojne me shume se 50% te kapitalit te Shoqerise per ndryshimin e ketij Akt Themelimi dhe Statuti, zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te Shoqerise, shpe rn darje n e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e Shoqerise.

KREU IV ADMINISTRIMI I SHOQERISE


NENI 11 ADMINISTRIMI I SHOQERISE

11.1 Shoqëria administrohet nga një apo më shumë Administratorë të cilët zgjidhen nga Asambleja e Përgjithshme për një periudhe prej 5 (pese) vjetësh . Administratori mund te rizgjidhet dhe shkarkohet në cdo kohë nga Asambleja e Pergjithshme.

11.2 Administratori zoteron kompetanca te plota ne lidhje me administrimin e Shoqerise dhe mund te kryeje te gjitha aktet qe konsideron te nevojshme per realizimin e objektit te

Shoqerise, pervec; atyre qe ligji apo ky Akt Themelimi dhe Statut ia rezervon Asamblese se Pergjithshme apo organeve te tjera te Shoqerise.

11.3 Administratori vepron në përputhje me politikat tregtare të vendosura nga Asambleja



AKT THEMELIMI DHE STATUT: "BRIDO " SHPK

e Pergjithshme. Administratori eshte perjegjes per veprimet e kryera ne administrimin e Shoqerise. Administratori mund te delegoje persona te trete per kryerjen e veprimeve dhe akteve qe kane te bejne me administrimin e Shoqerise, duke mbajtur perjegjesi per te gjitha veprimet e kryera nga te tretet e deleguar per admisnistrimin e Shoqerise.

11.4 Administratori do te veproje ne cdo kohe vetem ne interes in me te mire te Shoqerise. Ne rast konflikti interesit, Administratori do te njoftoje menjehere ortaket si dhe do te heq dorë nga cdo veprim qe lidhet me objektin e konfliktit te interesit deri ne marrjen e udhezimeve nga Asambleja e Pergjithshme.

11.5 Administratori i parë i Shoqërisë do të jetë :

- ◆ z. Muharrem Domi, mbajtës I letërnjoftimit me numër Personal: H90724133B,

NENI 12 SHPERBLIMI I ADMINISTRATORIT

12.1 Asambleja e Pergjithshme percakton shpe rblimin e Administratorit të Shoqërisë.

NENI 13 PERFUNDIMI I DETYRES SE ADMINISTRATORIT

13.1 Detyra e Administratorit përfundon në rast se:

- (a) i përfundon mandati;
- (b) shkarkohet nga Asambleja e Pergjithshme;
- (c) jep doreheqjen nga detyra duke njoftuar Shoqerine;
- (d) personi nuk gezon cilesine e Administratorit sipas parashikimeve te ligjit;
- (e) mungon pa arsyre ne detyre per me shume se 6 (gjashte) muaj radhazi

dhe Asambleja e Pergjithshme vendos ta shkarkoje nga detyra.

KREU V KONTROLLI FINANCIAR I SHOQERISE, VITI FINANCIAR, BILANCI VJETOR, DIVIDENDI


NENI 14 KONTROLLI FINANCIAR

14.1 Kontrolli financiar i Shoqërise kryhet në përputhje dhe sipas legjislacionit shqiptar ne fuqi. Asambleja e Përgjithshme do te emëroje një apo me shume Eksperte

Kontabël te Autorizuar ne ato raste kur emvrimi i tyre konsiderohet i nevojshëm ose kërcohët ne bazë të ligjit.

NENI 15 VITI FINANCIAR

Faqe 7 nga 8



AKT THEMELIMI DHE STATUT: "BRIDO " SHPK

15.1 Viti Financiar i Shoqerise fillon më 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor te do viti.

NENI 16 BILANCI VJETOR

- 16.1 Bilanci vjetor, pasqyrat financiare, inventari, raportet e Administratorit dhe te Ekspertit Kontabel te Autorizuar (nese jane emeruar) miratohen nga Asambleja e Pergjithshme. Administratori i paraqet per miratim Asamblese se Pergjithshme reportin mbi administrimin e Shoqerise si edhe llogarite vjetore.
- 16.2 Dokumentet qe kane te bejne me vitin financiar miratohen nga Asambleja e Pergjithshme brenda 6 (gjashte) muajve nga mbyllja e vitit fina nciar.

NENI 17 DIVIDENDI

- 17.1 Pasi te jenë përbushur kërkesat e përcaktuara nga Ligji per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare, Shoqeria, me shumice te kualifikuar te votave se Asamblese

Pergjithshme, mund te vendose shperndarjen e dividendeve ne perputhje me te drejtat perkatese te ortakeve.

- 17.2 Me perjashtim te rasteve kur parashikohet ndryshe nga te drejtat qe i bashkengjiten kuotave, te gjithe dividendet duhet te deklarohen dhe paguhen sipas shumave te paguara ne kuotat ne te cilat paguhet dividendi. Te gjitha dividendet do te shperndahen dhe paguhen ne menyre proporcionale me shumat e paguara mbi kuotat gjate do pjesë ose pjeseve te periudhes ne te cilen paguhet dividendi.



AKT THEMELIMI DHE STATUT " BRIDO " SHPK

**KREU VI
PRISHJA DHE LIKUIDIMI, LIGJI I ZBATUESHEM,
ZGJIDHJA E MOSMARREVESHJEVE**

NENI 18 PRISHJA DHE LIKUIDIMI I SHOQERISE

18.1 Ne rastin e prishjes dhe likuidimit te Shoqerise do te zbatohen dispozitat e parashikuara ne ligjin per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare.

NENI 19 LIGJI I ZBATUESHEM

19.1 Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plate me kete Akt Themelimi e Statut dhe ligjin shqiptar. Per sa nuk eshte parashikuar ne kete akt, do te zbatohen dispozitat e legjislacionit shqiptar ne fushen e shoqerive tregtare.

NENI 20 ZGJIDHJA E MOSMARREVESHJEVE

20.1 Mos marrëveshhjet që mund të lindin ndërmjet Shoqerise dhe ortakeve, apo ndermjet ortakeve dhe trashegimtareve te ortakeve ose ortakeve te tjere dhe/ose Shoqerise, qe kane per objekt te drejta te lidhura me Shoqerine, do te zgjidhen miqesisht ndermjet paleve te interesuara. Ne rast se palet nuk arrijne nje zgjidhje miqesore, Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tiranë do te jete kompetente per zgjidhjen e mosmarreveshjeve.

Ky Akt Themelimi dhe Statut hartohet dhe nenshkruehet ne 3 (tre) kopje ne gjuhen shqipe:

ORTAKU VETEM I SHOQERISE: "BRIDO" SHPK

MUHARREM DOMI

Muharrem Domi

